



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit të Komunës
Drenas, më 05.07.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY		
Pranuar	05.07.2021	
Nj. Org	Nr. Nr	Vlera
052/01	29999	

Procesverbali i tubimit me Publikun

Në vështrim të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 dhe 26 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 7 pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të Rregullores Komunale për Transparencë, Objektivit 4, pika 4.1 të Planit të Veprimit për Përmbushjen e Transparencës Komunale 2019-2023, Komuna e Drenasit ka organizuar tubim me publikun duke raportuar për punën e gjashtëmuorit të parë për vitin 2021.



Mbledhjen e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke filluar në ora 10:00, ku të pranishëm ishin: Nënkryetari i Komunës, Arben Shala, Drejtorët e Drejtorive komunale, administrator të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve dhe qytetarë.

Bekim Dobra - I nderuari nënkryetari i Komunës, z. Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, administrator të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, organizatave jo qeveritare, ju qytetarë. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin gjatë

gjashtëmujorit të parë, të vitit fiskal, pra ky qe ne sot po e mbajmë, dhe tjetri në fundvit. Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë njoftimin dhe ka publikuar dy javë para në ueb faqe të Komunës, në rrjetin social të Komunës, njoftimi është vendosur edhe ne dy hyrjet e objektit të Komunës si dhe në mediat online.

Të nderuar të pranishëm. Ndjej për obligim të ju njoftoj për rregullat e takimit! Tubimi me publikun ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës ju njoftojnë për aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë pjesës së dytë të këtij viti, ndërsa ju të pranishëm, mund të bëni pyetje dhe të jepni propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit dhe çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Për të elaboruar aktivitetet e Komunës ne gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për sukseset dhe sfidat, ftoj nënkryetarin e Komunës, z. Arben Shala.

Nënkryetari Arben Shala – Të nderuar qytetarë të Drenasit

Ju administratorë të vendbanimeve

Ju faleminderit që keni gjetur kohën të jeni sot pjesëmarrës në këtë tubim me publikun.

Ndonëse, vitin e kaluar e kemi kaluar me shumë sfida, për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia globale e virusit covid-19 e që ka vazhduar edhe gjatë këtij viti, ne me të gjitha kapacitetet jemi mundurar që t'i realizojmë të gjitha projektet e planifikuara sipas buxhetit të miratuar në Kuvendin Komunal.

Falënderoj të gjithë qytetarët, të cilët na kanë mirëkuptuar e bashkëpunuar në arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta. Falënderoj në veçanti administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën e tyre, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për realizimin e synimeve të përbashkëta për të mirën e përgjithshme. Me ndihmën e administratorëve, Shtabit Emergjent Qendrës Operative Emergjente, nënshataveve emergjente dhe me ndihmën e dhjetëra donatorëve lokal, vendor e ndërkombëtar, kemi arritur që sadopak të ju lehtësojmë gjendjen mbi 6 mijë ekonomive familjare, duke ju ndarë pako ushqimore e higjienike. E kemi nisur këtë vit, me lajmin me të mirë, duke u rikonfirmuar se Komuna jonë mbetet e para në nivel vendi në performancë të mirë dhe kemi fituar grantin mbi 500 mijë euro. Mjetet e këtij granti do të shfrytëzohen në realizimin e projekteve për të mirën e komunitetit dhe paraprakisht kemi nënshkruar edhe Memorandum Bashkëpunimi për realizimin e projekteve.

Të nderuar të pranishëm,

Gjatë kësaj periudhe sa po raportojmë, kanë nisur së realizuari dhjetëra projekte infrastrukturore, ku janë asfaltuar e do të asfaltohen disa rrugica, gjithmonë sipas planit të parashikuar. Po ashtu po vazhdon rregullimi i rrjetit të kanalizimit në shumicën e vendbanimeve dhe synim vetës i kemi dhënë që shumë shpejtë këtë problem të zgjidhim në secilin vendbanim, duke finalizuar edhe ndërtimin e kolektorëve për të trajtuar të gjitha ujërat e zeza. Ju jeni në dijeni, që vitin e kaluar kemi filluar me realizimin e projektit për ndriçimin publik në shumë lagje të fshatrave dhe këtë vit ky projekt po vazhdon të zgjerohet edhe në lagje të tjera. Këtë vit janë të planifikuara mbi 45 kilometra ndriçim. Po ashtu për të ju lehtësuar qytetarëve qarkullimin, sidomos nxënësve për të ju siguruar vajtje-ardhje në shkollë, kemi realizuar e do të realizojmë edhe rregullimin e trotuareve. Ky vit do të jetë përmbyllës i ndërtimit të ri të rrjetit elektrik në të gjitha vendbanimet, projekt ky i cili është mbi 10 milion euro. Renovimi i QMF-ve e AMF-ve, ndërsa këtë vit do të filloj ndërtimi edhe i objektit të ri të QKMF-së. Renovimi i objekteve shkollore, krijimi i kabineteve të informatikës në të gjitha shkollat, funksionalizimi i të gjitha shkollave me laboratorë, vendosja e kamerave të sigurisë ne objekte shkollore, pajisja e të gjitha shkollave me inventar, llaptop, projektor, tv e tableta të mençur.

Po vazhdojmë në përkrahjen e fermerëve përmes subvencionimit me pajisje të nevojshme për të ju lehtësuar punën, ndarja e serave për fermer, furnizimi me makina mjelëse, subvencionim të fermerëve me makina për krasitjen e pemëve si dhe do të vazhdojmë edhe në lëmi të tjera në përkrahjen e fermerëve. Edhe në mjedis kemi vazhduar kujdesin ndaj tij, kemi mbjellë mijëra fidanë në sheshin “Fehmi Lladrovci” e pemë dekorative në vende të ndryshme, mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror dhe veror, mirëmbajtja e kanalizimeve, mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katër, mirëmbajtja e parqeve, shesheve e gjelbërimi i hapësirave publike, mirëmbajtja e ndriçimit publik, kujdesi dhe zgjerimi për menaxhimin e mbeturinave, pastrimi i deponive ilegale dhe shumë e shumë projekte të tjera publike. Edhe në sektorin e kulturës, rinisë e sportit jemi duke vazhduar me realizimin e projekteve. Tri fusha janë në procedurë të renovimit dhe dy të tjera në procedurë të ndërtimit. Stadiumi i qytetit “Rexhep Rexhepi”, dal ngadalë po merr formën e finalizimit duke i plotësuar standardet e FIFA dhe UEFA. Palestra “Hysni Jetullahi” shumë shpejtë do të rinovohet, ku jemi fitues i fondit të eficiencës dhe shumë shpejtë sikurse viteve të tjera, do të filloj subvencionimi për sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit.

Të nderuar të pranishëm,

Duke marr edhe propozimet tuaja të dala nga dëgjimet buxhetore, ne kemi arritur t’i realizojmë thuajse të gjitha projektet e planifikuara, prandaj ju ftoj që edhe në gjashtëmujorin e mbetur të këtij viti dhe viteve në vazhdim të bashkëpunojmë për të mirën e qytetarëve, duke ju lehtësuar atyre jetën në komunitet me realizimin e projekteve.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Bekim Dobra - Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht kur të merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit për t’i adresuar kërkesat, apo sugjerimet tuaja.

Samedin Kiqina – administrator i fshatit Baicë – në fshatin tonë Baicë janë kryer disa punë në rregullimin e infrastrukturës, por kemi nevojë për tri rrugë që duhet të kryhen në pjesën e mbetur të këtij viti. Paraprakisht kisha kërkuar nga ekzekutivi që kur të kryhen punimet të njoftohen administratoret e vendbanimeve për arsye që ato të jenë me cilësinë e duhur. Kemi nevojë për asfaltimin e rrugës që ka mbetur pa u përfunduar në lagjen Vrellaku e po ashtu edhe një pjesë e lagjeve kanë mbetur pa rrjet të kanalizimit e është mirë që ky projekt të finalizohet në të gjitha lagjet. Kemi nevojë në disa rugica të shtrohet me zhavorr sepse e di që nuk ka mjete buxhetore për t’u asfaltuar gjatë këtij viti, por të paktën të behën të kalueshme. Po ashtu kemi nevojë për rrethojnë e varrezave të fshatit dhe këtë vit e di që keni disa kilometra për ndriçim, është mirë të ndahen disa metra që të përfshihen disa lagje të fshatit Baicë në këtë projekt.

Endrit Gllareva – drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale – i mora të gjitha kërkesat e adresuara nga ana juaj dhe sipas mundësive buxhetore do të realizohen. Gjatë këtij viti ka projekte që do të kryhen në fshatin tuaj e po ashtu në disa metra do të kryhen edhe ndriçim në lagjet e fshatit Baicë.

Lumnije Krap – drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë – kërkesa juaj për zhavorr në disa lagje do të mundohemi që t’i kryejmë ato rrugë që janë me prioritet e po ashtu kemi planifikim të projektit për rrethojnë të varrezave në disa lagje do të kryhen gjatë këtij viti, por kemi shumë vendbanime të tjera dhe nuk do të kryhen të gjitha në fshatin Baicë.

Avdyl Gashi – Qendra e Rinisë në Drenas – me keqardhje, por me projektet që po i zhvillon, rininë nuk e keni prioritet në Drenas për sa e sa vite, jo vetëm për rininë, por edhe ne përgjithësi për kulturën e sportin. Pse nuk po jepet ende në shfrytëzim Qendra e Rinisë në Drenas që sa vite, që është përfunduar renovimi

dhe ende vazhdon me ka si objekt pa asnjë aktivitet. Po ashtu edhe Qendrën e Grave që është ndërtuar afër Qendrës Rinore, nuk po e jepni në shfrytëzim, po ashtu edhe Salla e Kulturës pse nuk jepet në shfrytëzim për të rinjtë. Është ndërtuar inkubatori në Qendrën e Bizneseve dhe ende nuk e keni në funksion, i cili kish me i ndihmi jo vetëm bizneseve në Parkun e Biznesit, por të gjitha bizneseve tjera në Drenas. Subvencionet për kulturë, rini e sport pse nuk i po i hapni këtë vit ende, po i leni në fund të vitit.

Muhamet Gjoka – Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – Qendra e Rinisë në Drenas është në procedurën e dhënies në shfrytëzim sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe së shpejti do të jetë e gatshme për destinimin që është ndërtuar. Po ashtu edhe Qendra e Grave në Drenas është në të njëjtën procedurë të shfrytëzimit për OJQ-të. Inkubatori në Parkun e Biznesit është në kuadër të KIESA në Ministrinë e Infrastrukturës, por jemi në dijeni që edhe ai inkubator është në procedurë të dhënies. Ndërsa sa i përket subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport, janë kryer të gjitha procedurat dhe në fillim të muajit Korrik do të behët shpallja publike për personat fizik dhe ojq-të për të qenë përfitues të subvencioneve nga kjo drejtori.

Mërgim Shala – përfaqësues nga fshati Negroc – shqetësimi i fshatit tonë është që drejtorët komunal që po zhvillojnë projekte, nuk po bashkëpunojnë me përfaqësues të lagjeve në mënyrë që projektet të kryhen sipas planifikimit dhe projektit. Fshati jonë ka nevojë për 1770 metra kanalizim që nuk është kryer e po ashtu janë edhe 1500 metra në disa lagje që kanë nevojë për asfalt. Kisha kërkuar po ashtu që gjatë këtij viti që keni projekt për ndriçim të përfshihet edhe fshati Negroc.

Endrit Gllareva – drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale – kemi në projekt gjatë këtij viti edhe rregullim të kanalizimeve në disa vendbanime e po ashtu edhe në fshatin Negroc e po ashtu janë planifikuar edhe 300 metra ndriçim në fshatin tuaj, ndërsa për asfalt po ashtu gjatë këtij viti nëse ka mundësi buxhetore do të asfaltohen lagjet që janë me shtëpi banimi më shumë.

Salih Berisha – përfaqësues nga Komorani III – tek në kur gjatë zhvillimit të projektit është dëmtuar rrjeti i kanalizimit dhe ujësjellësit dhe ende nuk është riparuar, prandaj kërkojë që të riparohen këto dëme sepse po kemi problem edhe me ujërat e zeza që kanë dalë në sipërfaqe e po ashtu edhe mungesë të ujit për pije, sidomos tash në sezonin veror. Komorani III ka nevojë edhe për disa metra për rregullimin e rrjeti të kanalizimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm e po ashtu edhe për ndriçim të lagjeve. Po ashtu kemi nevojë edhe për asfaltim të disa lagjeve.

Endrit Gllareva – drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale – i shënova të gjitha kërkesat e juaja dhe shqetësimet dhe sipas mundësive buxhetore do të merren parasysh të gjitha.

Afrim Gjeli – administrator i Pokleku të Ri – Pokleku vazhdon të mbetet me problemi kryesor për mungesë të ujit për pije, prandaj kisha kërkuar që gjatë këtij viti të zgjidhet ky problem i kamotshëm. Po ashtu kemi nevojë edhe për rregullimin dhe rrethojnë e varrezave të fshatit, asfaltim në dy lagje dhe ndriçim të rrugëve të mbetura që ende nuk është bërë sepse jemi si paralagje e qytetit dhe kemi nevojë për më shumë rrugë të jenë në ndriçim. Po ashtu është mirë që përmes nivelit qendror të behët zgjidhja e banesave kolektive në Poklek.

Imri Bajraktari – administrator i Drenasit III – të gjitha kërkesat e mia i kam përgatitur dhe në takimet e kaluar i kam paraqitur. Është mirë të behët një zgjidhje sa më e shpejtë e qenve endacak, sepse tek ne kanë qenë 3 sulme nga ta dhe po rrezikohen fëmijët dhe të rritur nga ta. Po ashtu tek ne është mirë të përfundon trotuari në disa lagje, rrjeti i kanalizimit dhe ndriçimi.

Lumnije Krapi – drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë – problemi me trajtimin e qenve endacak, më herët ka qenë në menaxhim të AVUK-ut, por nga ky vit është në kompetencë të

drejtorisë tonë dhe kemi shpallur tenderin për trajtimin e tyre. Për momentin është vetëm trajtimi i tyre, deri sa të krijohet një strehimore e tyre që mendohet të behët regionale duke përfshirë tri me shumë komuna.

Xhevdet Demaku – administrator i fshatit Abri – në fshatin tonë ka nevojë për ndriçim pasi që keni projekt gjatë këtij viti dhe është mirë të ndahen disa metra edhe për fshatin tonë. Po ashtu ne kemi nevojë që gjatë këtij viti të realizohen disa rrugë në lagje sepse janë kërkesat që nga viti i kaluar dhe me disa projekte që i kam pa, është i përfshirë edhe fshati Abri dhe është mirë që të fillohet sa më shpejtë realizmi i projektit në terren. Fshati Abri ka edhe disa lagje që nuk janë përfshirë në rrjetin e kanalizimit, dhe kërkojë që gjatë këtij viti të kryhet edhe ky projekt në mënyrë që të përfshihet i gjithë fshati në rrjetin e kanalizimit.

Endrit Gllareva – drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale – të gjitha kërkesat e juaja i kam shënuar dhe presim që gjatë këtij viti disa prej tyre t'i realizojmë sipas mundësive buxhetore që i kemi. Në projekt janë disa metra ndriçim në fshatin Abri e po ashtu gjatë këtij viti presim të përmbyllim edhe projektin e kanalizimit me ndërtimin e kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza e po ashtu edhe asfaltimin e disa rrugicave në fshatin Abri, gjithmonë sipas mundësive buxhetore që kemi.

Kadri Ajazi – administrator i fshatit Sankoc – në fshatin tonë janë realizuar disa projekte, por kanë mbetur ende disa lagje pa u përfshirë në rrjetin e kanalizimit e po ashtu edhe në lagjen Ramaj kemi nevojë për asfaltim të kësaj lagje. Në fshatin Sankoc është shumë e nevojshme ndërtimi i trotuarit në afërsi të shkollës e po ashtu të zgjerohet edhe rrjeti i ndriçimit në të gjitha lagjet.

Endrit Gllareva – drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale – i kam marr të gjitha kërkesat e adresuara i kam regjistruara dhe sipas mundësive buxhetore do të kryhen gjatë këtij viti do të kryhen. Siç e përmenda edhe për të tjerët, këtë vit kemi do të rregullohet ndriçimi në shumë fshatra e ne paramasë ka ndriçim edhe në fshatin Sankoc.

Zekë Kluna – administrator i fshatit Poklek i Vjetër – kemi shumë kërkesa në fshatin tonë, e disa janë realizuar dhe u jemi mirënjohës për bashkëpunimin e treguar ndër vite, por kemi nevojë për rregullimin e varrezave, sepse janë në gjendje shumë të keqe e ka nevojë për rregullimin e rrethojës së tyre. Drejtori i përmendi ndriçimin, besoj që do të kryhet gjatë këtij viti ndonjë lagje.

Endrit Gllareva – drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale – në projekt është i përfshirë edhe ndriçimi në fshatin Poklek i Vjetër, i gjithë fshati nuk do të mund të mbulohet gjatë këtij viti sepse kemi shumë vendbanime e në projekt për këtë vit i kemi vetëm 40 kilometra për të gjitha fshatrat.

Lumnije Krapit – drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë – sipas mundësive buxhetore që kemi gjatë këtij viti, do të behët rrethoja e varrezave në fshatin tuaj.

Qerim Berbatovci – Administrator i fshatit Godanc – në fshatin tonë kemi nevojë që në disa lagje gjatë këtij viti të shtrohen me zhavorr e në disa me asfalt. Po ashtu kemi nevojë edhe për ndriçim të lagjeve. Rrjeti i kanalizimit nuk është përfunduar i teri në fshatin tonë, prandaj është mirë që gjatë këtij viti të kryhet ky projekt që të përfshihen të gjitha lagjet e fshatit Godanc.

Procesmbajtës:

Bekim Dobri

